



Komisioni i Pavarur i Kualifikimit




Raport Statistikor **Shkurt 2018 – Gusht 2019**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nga data 8 shkurt 2018 deri në datën 31 gusht 2019 ka dhënë 189 vendime.


- **81** vendime për konfirmimin në detyrë të 33 gjyqtarëve, 40 prokurorëve dhe 8 ndihmësve ligjorë/kandidatë për magjistratë;
- **68** vendime për shkarkimin nga detyra të 40 gjyqtarëve, 26 prokurorëve dhe 2 ndihmësve ligjorë/kandidatë për magjistratë;
- **15** vendime për ndërprerjen e procesit të 10 gjyqtarëve, 4 prokurorëve dhe 1 ish-ndihmës ligjor;
- **8** vendime për pushimin e procesit të 3 gjyqtarëve, 1 prokurori dhe 4 ndihmësve ligjorë;
- **16** vendime për përfundimin e procesit pa një vendim përfundimtar, për kryeinspektoren e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, 10 gjyqtarëve dhe 5 prokurorëve;
- **1** vendim për pezullim nga detyra për një periudhë 1-vjeçare.

Këto vendime pasqyrohen në grafikët e mëposhtëm.


Grafik 1: Vendimet e KPK-së, 8 shkurt 2018 – 31 gusht 2019




Grafik 2: Konfirmimet në detyrë në bazë të funksionit të subjektit të rivlerësimit



Grafik 3: Shkarkimet nga detyra në bazë të funksionit të subjektit të rivlerësimit




Grafik 4: Ndërprerjet e procesit në bazë të nenit G të Aneksit të Kushtetutës




KOMISIONI I
Pavarur i
Kualifikimit


Grafik 5: Pushimi i procesit sipas nenit 56 të ligjit nr. 84/2016



Grafik 6: Përfundimet e procesit pa një vendim përfundimtar




Grafik 7: Përzullimet nga detyra




Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka dhënë **178** vendime me unanimitet, ku të gjithë anëtarët e trupit gjykues kanë votuar në mënyrë të njëjtë dhe **11** vendime me shumicë votash.

Grafik 8: Vendime me unanimitet dhe shumicë votash



Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka dhënë **18** vendime bazuar në një kriter, **13** vendime bazuar në dy kritere dhe **120** bazuar në të tre kriteret e rivlerësimit.

Grafik 9: Numri i vendimeve sipas kritereve të rivlerësimit



Në grafikun e mëposhtëm pasqyrohet vendimmarrja e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit pas ankimimit të vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Kolegji i Posaçëm i Apelimit, deri më 31 gusht 2019, ka marrë 32 vendime nga të cilat:

a) **20** lënie në fuqi të vendimeve të Komisionit;


b) **10** ndryshim vendimi, prej të cilave;

2 vendime të ndryshuara pjesërisht (subjektet M. Fana, A. Llalla) dhe 8 vendime të ndryshuara plotësisht (për subjektet B. Dedja, A. Sevdari dhe A. Faqolli, E. Islamaj, A. Brati, V. Bala, Xh. Zaganjori, G. Osmani) ;

c) **1** prishje të vendimit (për subjektin A. Lazaj) ;

d) **1** pushim të shqyrtimit (për subjektin S. Tola).


Grafik 10: Vendimmarrja e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit



Organet ndihmëse të Komisionit në këtë proces janë Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) për vlerësimin e pasurisë dhe Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) për vlerësimin e figurës. Vendimmarrja e Komisionit nuk është e kushtëzuar nga përfundimet e rezultateve të këtyre raporteve, pasi Kushtetuta i njeh KPK-së të drejtën e një hetimi të pavarur.


Sipas raporteve të ILDKPKI-së për **150** subjekte rivlerësimi, kanë rezultuar pa probleme me pasurinë **102** subjekte rivlerësimi dhe me probleme **48** prej tyre, ndërkohë që hetimi i kryer nga Komisioni ka dhënë rezultate të tjera: kanë rezultuar **67** subjekte pa probleme me pasurinë dhe **83** subjekte me probleme.

Grafik 11: Raporti i ILDKPKI-së dhe rivlerësimi i KPK-së



Nga raportet e DSIK-së për **131** subjekte rivlerësimi, kanë rezultuar të papërshtatshëm për vijimin e detyrës **27** subjekte rivlerësimi, ndërkohë që nga hetimi i Komisionit rezultuan me probleme **19** prej tyre.

Grafik 12: Raporti i DSIK-së dhe kontrolli i figurës i KPK-së



Kualifikimit